



**Publikim Special**

**Qershor 2020**

# **Komunat e Rajonit të Prishtinës**

## **Profilet Socio-Ekonomike**

*Ky botim është pjesë e Programit të Konzortiumit të OJQ-ve (ATRC, KIPRED, BIRN, SPRC, KCBS dhe D+)  
“Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm”.*

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorcium: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm"



*Përgatitur nga: Lulzim Peci, Mentor Agani, Diedon Nixha dhe Valdrin Ukshini*

*Copyright © 2020, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo: +383 38 542 778*

*Botuar nga:*



*Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)*

*Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1*

*10 000 Prishtinë, Kosovë*

*Telefoni dhe faksi: +383 38 542 778*

## **Përmbajtja:**

Përmbledhje Ekzekutive	4
Profili i Komunës së Prishtinës	7
Profili i Komunës së Podujevës	13
Profili i Komunës së Glllogocit	18
Profili i Komunës së Lipjanit	23
Profili i Komunës së Fushë Kosovës	28
Profili i Komunës së Obiliqit	33
Profili i Komunës së Graçanicës	38

## Përmbledhje Ekzekutive

Qëllim i këtyre profileve të komunave të Rajonit të Prishtinës është të përdoren si shtytje për hapjen e debatit publik, dhe t'i ndihmojnë vendim-marrësit komunalë dhe kombëtarë në formulimin dhe zbatimin e politikave që do t'i adresojnë nevojat e popullatës rinore, gjegjësisht të grup-moshës 15-29 vjet.

Për këtë qëllim, KIPRED-i ka përmbledhur të dhënat për strukturën e popullatës dhe lëvizjet demografike, për nivelin dhe strukturën e arsimit, të kulturës dhe të sportit, strukturën religjioze, përfshirë këtu edhe numrin e objekteve dhe të klerikëve fetarë, ekstremizmin e dhunshëm, nivelin e kriminalitetit, strukturën e popullatës sipas aktivitetit ekonomik, buxhetet komunale dhe mbështetjen që ato e ofrojnë për aktivitetet rinore, për komunat e Prishtinës, të Podujevës, të Glogocit, të Lipjanit, të Fushë Kosovës, të Obiliqit, dhe të Graçanicës.

Të dhënat tregojnë që, me përjashtim të komunave të Prishtinës dhe të Fushë Kosovës, shumica e popullatës së grup-moshës 15-29 vjet të komunave të këtij rajoni jetojnë në pjesët rurale të këtyre komunave. Nivelin më të lartë të arsimit e ka Komuna e Prishtinës, më pas vjen Komuna e Graçanicës, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna Glogocit, Komuna e Lipjanit, Komuna e Podujevës, ndërkaq Komuna e Obiliqit qëndron më së dobëti në rajon.

Komuna e Prishtinës ka infrastrukturë solide kulturore dhe sportive për të rinjtë, ndërsa në komunat e tjera të rajonit, kjo infrastrukturë është në mënyrë të ndjeshme më e dobët.

Në Komunën e Prishtinës, raporti xhami për banorë në fshatra është 0.5 xhami në 1000 banorë, ndërsa në qytet është 0.17 xhami në 1000 banorë; në Komunën e Podujevës ky raport është 0.6 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.13 xhami në 1000 banorë në qytet; në Komunën e Glogocit, 0.3 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.16 xhami në 1000 banorë në qytet; në Komunën e Lipjanit, 0.61 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.14 xhami në 1000 banorë në qytet; në Komunën e Fushë Kosovës, 0.8 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.1 xhami në 1000 banorë në qytet; në Komunën e Obiliqit, 1.1 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.3 xhami në 1000 banorë në qytet; dhe në Komunën e Graçanicës 0.1 xhami në 1000 banorë.

Numri i individëve që u janë bashkangjitur luftërave të huaja, domethënë, organizatave terroriste në Irak dhe Siri, për Komunën e Prishtinës është 0.3 në 1000 banorë, për Komunën e Podujevës 0.03 individë në 1000 banorë, për Komunën e Glllogocit 0.01 individë në 1000 banorë, për Komunën e Lipjanit 0.2 individë në 1000 banorë, për Komunën e Fushë Kosovës 0.17 individë në 1000 banorë, për Komunën e Obiliqit 0.23 individë në 1000 banorë, dhe Komuna e Graçanicës nuk e ka asnjë rast. Në përgjithësi, gjendja ekonomike e këtyre individëve kryesisht është e dobët, dhe ata kryesisht kanë shkollim të ulët dhe të mesëm.

Numri i veprave penale për 1000 banorë është më i larti në Komunën e Graçanicës, 48, dhe më i ulëti në Komunën e Podujevës, 11, ndërsa në Prishtinë ky numër është 31, në Komunën e Fushë Kosovës 36, Komunën e Lipjanit dhe të Obiliqit 15 dhe në Komunën e Glllogocit 12.

Në Komunën e Prishtinës 2.5% e popullatës janë në gjendje të rëndë ekonomike, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërsa 5.9% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet; në Komunën e Podujevës 4% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 5.8% nga pensionet; në Komunën e Glllogocit, 7.1% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 6.8% nga pensionet; në Komunën e Lipjanit, 7.9% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 6.7% nga pensionet; në Komunën e Fushë Kosovës 8.2% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 5.5% nga pensionet; në Komunën e Obiliqit 8.9% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 5.3% nga pensionet; dhe në Komunën e Graçanicës 4% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 10% nga pensionet.

Për sa i përket shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve për kulturë, sport dhe rini, në Komunën e Prishtinës këto paraqesin 19.2% të vlerës së përgjithshme të shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve, në atë të Podujevës 2.8%, në atë të Glllogocit 6%, në atë të Lipjanit 11.7%, në atë të Fushë Kosovës 5.1%, në atë të Obiliqit 10.6%, dhe në atë të Graçanicës 2.2%. Pos në Komunën e Prishtinës, këto shpenzime nuk i plotësojnë as për së afërmi nevojat për aktivitetet jashtëshkollore të të rinjve të këtyre komunave.

Në fund, në tabelën e mëposhtme është dhënë një pasqyrë e përmbledhur e të dhënave socio-ekonomike për komunat e rajonit të Prishtinës.



	Prishtina	Podujeva	Drenas	Lipjan	Fushë Kosovë	Obiliq	Graçanica
<b>Popullata</b>	198897	88499	58531	57605	34827	21549	10675
<b>Grup-mosha 15-29</b>	26.5%	27.5%	29.7%	27.5%	26.6%	27.1%	25.2%
Qyteti	81.0%	26.4%	10.3%	11.9%	51.5%	31.5%	*
Fshati	19.0%	73.6%	89.7%	88.1%	48.5%	68.5%	100.0%
<b>Niveli i Arsimit</b>							
Analfabetë (në 1000 banorë)	29	49	38	51	59	43	26
Pa shkollim fillor (në 1000 banorë)	75	112	90	92	114	103	76
Shkolla fillore (në 1000 banorë)	359	527	517	528	425	454	377
Shkolla e mesme (në 1000 banorë)	379	304	332	303	369	387	452
Studimet e larta (në 1000 banorë)	186	55	60	56	92	54	94
Institucione shkollore fillore dhe të mesme	72	59	32	54	16	18	3
<b>Religjioni</b>							
Xhamitë	46	41	18	32	15	18	1
Klerikë Islam	52	43	16	34	18	20	1
Kisha Katolike	2	*	1	2	*	*	*
Klerikë Katolikë	9	*	*	1	*	*	*
Kisha protestante	2	*	1	*	*	*	*
Klerikë protestantë	25	1	2	4	5	1	1
Kisha ortodokse	1	*	*	3	2	3	12
<b>Luftëtarë të Huaj Terroristë</b>	58	3	1	11	6	5	
Mosha mesatare	19-50	20-30	20-25	19-50	19-50	20-30	*
Niveli i Arsimit	Ulët/Mesëm	Ulët/Mesëm	Mesëm	Mesëm	Mesëm	Mesëm	*
Gjendja ekonomike	Dobët	Dobët	Dobët	Dobët	Dobët	Dobët	*
<b>Kriminaliteti (vepra penale/në 1000 banorë)</b>	31	11	12	15	36	15	48
<b>Gjendja ekonomike</b>							
Popullata ekonomikisht aktive	51.2%	35.9%	40.3%	39.8%	47.8%	46.3%	50.3%
Të punësuar	72.3%	50.4%	44.0%	50.6%	63.9%	53.3%	63.1%
Me ndihma sociale	2.5%	3.9%	7.1%	7.9%	8.2%	8.9%	4.0%
Të varur nga pensioni	5.9%	5.8%	6.8%	6.7%	5.5%	5.3%	9.9%
<b>Buxheti komunal (EUR)</b>	91.5m	24m	16.5m	18m	12.6m	11.4m	8.1m
Shpenzimet kapitale dhe subvencionet	38.9%	30.8%	30.0%	30.0%	41.0%	49.6%	33.6%
Shpenzimet kapitale dhe subvencionet për rini	19.2%	2.8%	6.0%	11.7%	5.1%	10.6%	2.2%

## Profili i Komunës së Prishtinës

### **Fakte dhe shifra**

- **Struktura e popullsisë dhe lëvizjet demografike**

Prishtina është komuna më e madhe në Kosovë dhe kryeqyteti i saj. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë se Komuna e Prishtinës i ka patur 198,897 banorë, dhe se deri në vitin 2018 kjo shifër është ngritur për 15,791 banorë, që domethënë se komuna e Prishtinës tash i ka 214,688 banorë.<sup>1</sup> Sipas përkatësisë etnike, 97.7% të banorëve të Prishtinës janë shqiptarë, 1% turq, 0.3% ashkali dhe 1% i përkasin grupeve etnike të tjera. Raporti gjinor i popullatës është 49.9% meshkuj dhe 50.1% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta paraqesin 26.5% të popullsisë së përgjithshme të komunës, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (25.8%) dhe 30-80 vjet (47.7%).<sup>2</sup> Regjistrimi i popullsisë tregon se numri më i madh i të rinjve në Komunën e Prishtinës (81%) jetojnë në qytet, ndërkaj, pjesa tjetër prej 19% jeton në fshatrat e komunës.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: <http://ask.rksgov.net/media/4118/vlersimi-i-popullsisë-2017.pdf>

<sup>2</sup> Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>3</sup> Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit**

Të dhënat lidhur me nivelin e arsimit dhe njohjen e lexim-shkrimit për popullatën mbi 10 vjet tregojnë se në 1000 banorë, 29 janë analfabetë, 75 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 359 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 379 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 186 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare.<sup>4</sup>

Komuna e Prishtinës ka gjithsej 72 shkolla fillore dhe të mesme, me 2460 mësimdhënës,<sup>5</sup> me një raport 1 shkollë në 1000 banorë të moshës deri 19-vjeçare.

Në komunën e Prishtinës janë të regjistruar 105 klube sportive,<sup>6</sup> të cilat aktivitetet e tyre i zhvillojnë në objektet dhe fushat sportive që gjenden në këtë komunë, si Stadiumi Kombëtar “Fadil Vokrri,” Stadiumi “Flamurtari,” Stadiumi “Besëlidhja” në Llukar, fusha e futbollit në Hajvali, sallat e mbyllura sportive në Pallatin e Rinisë dhe 18 terrenet publike të hapura sportive, pa përfshirë këtu edhe sallat dhe terrenet sportive në shkollat fillore dhe të mesme të komunës.<sup>7</sup> Për sa i përket objekteve kulturore, në menaxhim komunal është Biblioteka e Qytetit “Hivzi Sulejmani” me qendër në Prishtinë, që i ka katër degë në qytet dhe gjashtë në fshatrat e komunës,<sup>8</sup> Teatri i Qytetit “Dodona” dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve. Ndërsa, në menaxhim të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës janë Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, Muzeu i Kosovës, Muzeu Etnologjik, Teatri Kombëtar, Galeria e Arteve të Kosovës dhe Galeria e Ministrisë së Kulturës.<sup>9</sup>

### **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 97.2% e popullatës së Prishtinës janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, të besimit ortodoks janë deklaruar 0.24%, të

---

<sup>4</sup> Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>5</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

<sup>6</sup> Lista e Klubeve Sportive në Komunën e Prishtinës, 2020

[https://prishtinaonline.com/uploads/lista\\_e\\_klubeve\\_publike\\_sportive%20\(1\).pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/lista_e_klubeve_publike_sportive%20(1).pdf)

<sup>7</sup> Hapësirat Rekreative Sportive në Komunën e Prishtinës, 2020

[https://prishtinaonline.com/uploads/investimet\\_kapitale\\_-\\_sport.pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/investimet_kapitale_-_sport.pdf)

<sup>8</sup> Bibliotekat, Prishtina Online, 2020, <https://prishtinaonline.com/drejtore/kultures-rinise-dhe-sportit/kulture/bibliotekat>,

<sup>9</sup> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, 2020, <https://www.mkr-ks.org/?page=1,119>



besimit katolik 0.58%, dhe 1.5% të tjerë janë personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.<sup>10</sup>

Në territorin e Komunës së Prishtinës janë funksionale 46 xhami, 28 prej të cilave janë në qytet dhe 18 ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve islamë është 52.<sup>11</sup> Këtu duhet theksuar që në periudhën kohore 2011-2018, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve islamë kanë hyrë 29 xhami të reja.<sup>12</sup> Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.5 xhami në 1000 banorë, ndërkaq, në qytet, 0.17 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, e dyta e të rinjëve, dhe e treta e grave.<sup>13</sup> Besimtarët katolikë në shërbim të tyre e kanë një katedrale dhe një kishë katolike dhe nëntë klerikë të lëshkvisë së Kosovës, besimtarët protestantë kanë dy kisha protestante dhe 25 klerikë protestantë,<sup>14</sup> ndërsa besimtarët ortodoksë kanë në shërbim një kishë.<sup>15</sup>

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u janë bashkangjitur 58 individë nga komuna e Prishtinës, përkatësisht, 0.3 individë në 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë se ata kanë nivel të ulët dhe të mesëm të shkollimit, dhe se janë në një gjendje ekonomike të dobët. Sa i përket këtyre individëve, 42 nga ta janë meshkuj dhe 16 janë femra, dhe mosha e tyre ndryshon nga 19 deri në 50 vjet. Po ashtu, duhet theksuar se në komunën e Prishtinës janë 16 individë të arrestuar për veprimtari terroriste apo për vepra të tjera të ndërlidhura me këtë veprimtari.<sup>16</sup>

---

<sup>10</sup> Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>11</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>12</sup> Organisation for Security and Cooperation in Europe, Prishtina Municipal Profile (2011).

<sup>13</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>14</sup> Të dhëna nga lëshkvia e Kosovës, 19 korrik 2018, dhe nga Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018.

<sup>15</sup> Organisation for Security and Cooperation in Europe, Prishtina Municipal Profile (2018),

[https://www.osce.org/files/f/documents/2/2/13127\\_1.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/2/2/13127_1.pdf)

<sup>16</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 28 maj 2020.


Këtu duhet theksuar se nuk ka evidencë publike që dëshmon se Kuvendi Komunal i Prishtinës deri më tash ka mbajtur qoftë edhe një mbledhje të vetme ku do të trajtohej ky problem i sigurisë.<sup>17</sup>

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Prishtinës tregojnë që brenda vitit të kaluar (2019) në këtë Komunë janë kryer 6218 vepra penale,<sup>18</sup> që don të thotë 31 vepra penale në 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel të lartë të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (3270), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (1378).<sup>19</sup>

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Prishtinës tregojnë se nga 147,494 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, 51.2% janë ekonomikisht aktivë – dhe 72.3% prej tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 48.8% e popullsisë mbi 15 vjet.<sup>20</sup> Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



<sup>17</sup> Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Prishtinës. <https://kk.rks.gov.net/prishtine/category/procesverbalet/ekstraktet-e-procesverbaleve-te-kuvendit/>

<sup>18</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 28 maj 2020.



<sup>19</sup> Ibid.

<sup>20</sup> Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 40.7% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa 34.7% kanë deklaruar që kujdesen për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të ceket se 2.5% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaj, 5.9% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.<sup>21</sup>

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2020, komuna e Prishtinës ka buxhet prej rreth 91.5 milionë €. Të hyrat në buxhet nga grantet qeveritare përbëjnë rreth 68% të totalit të tij, ndërsa rreth 32% Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Rreth 34.6% të buxhetit total shpenzohen për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 20.8%, ndërkaj, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 34.8% e shumës totale.<sup>22</sup>




Nëse analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe subvencionet për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, dhe më në veçanti, me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti e përfaqëson në mënyrë të kënaqshme këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që paraqet 26.5% të popullatës së përgjithshme të Komunës së Prishtinës.

<sup>21</sup> Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>22</sup> Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>.

Në buxhetin e vitit 2020, 7.47% (6,844,000 €) të buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që do të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe të subvencioneve, duke paraqitur 19.2% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 19.4% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 80.6% për shpenzime kapitale<sup>23</sup>.



---



<sup>23</sup> Ibid.

## Profili i Komunës së Podujevës

### *Fakte dhe shifra*

- **Struktura e popullsisë dhe lëvizjet demografike**

Podujeva është komuna e dytë në Rajonin e Prishtinës për nga numri i popullsisë. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë se Komuna e Podujevës i ka patur 88,499 banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër ka rënë për 5706 banorë, që domethënë se Podujeva tash i ka 82,793 banorë.<sup>24</sup> Sipas përkatësisë etnike, 98.9% e banorëve të Podujevës janë shqiptarë, 0.8% ashkali dhe 0.3% i përkasin grupeve etnike të tjera. Raporti gjinor i popullatës është 50.8% meshkuj, dhe 49.2% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta paraqesin 27.5% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (30.2%) dhe 30-80 vjet (42.3%).<sup>25</sup> Regjistrimi i popullsisë tregon që numri më i madh i të rinjve në Komunën e Podujevës (73.6%) jetojnë në fshatra, ndërkaj, pjesa tjetër prej 26.4% jeton në qytet.<sup>26</sup>

<sup>24</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku:

<http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullsisë-2017.pdf>

<sup>25</sup> Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>26</sup> Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat lidhur me nivelin e arsimit dhe njohjen e lexim-shkrimit për popullatën mbi 10 vjet tregojnë se në 1000 banorë, 49 janë analfabetë, 112 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 527 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 304 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 55 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare.<sup>27</sup>

Komuna e Podujevës ka gjithsej 62 shkolla fillore dhe të mesme, me 1161 mësimdhënës<sup>28</sup> dhe me një raport prej 1.7 shkollash në 1000 banorë të moshës deri në 19-vjeç.

Në Komunën e Podujevës funksionojnë 18 klube sportive dhe 6 shkolla sportive që i kanë në dispozicion 3 fusha të futbollit të madh, 17 fusha të futbollit të vogël, një palestër dhe dy komplekse sportive. Po ashtu, në komunë funksionon 1 bibliotekë, një qendër rinore dhe një teatër.<sup>29</sup>

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 99.7% e popullatës së Podujevës janë deklaruar të besimit Islam, ndërkaq, pjesa tjetër, 0,3% e banorëve, janë të besimit katolik, të besimit ortodoks, pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.<sup>30</sup>

Në territorin e Komunës së Podujevës janë funksionale 41 xhami, 3 prej të cilave janë në qytet dhe 38 ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve Islamë është 43.<sup>31</sup> Këtu duhet theksuar se gjatë periudhës kohore 2011-2018 në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve Islamë kanë hyrë tetë xhami të reja.<sup>32</sup> Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.6 xhami në 1000 banorë, ndërkaq, në qytet, 0.13 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku

---

<sup>27</sup> Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>28</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

<sup>29</sup> Infrastruktura Kulturore dhe Sportive në Komunën e Podujevës. Të dhëna të dërguara nga Drejtoria e kulturës në Komunën e Podujevës, 2 gusht 2018

<sup>30</sup> Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>31</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>32</sup> Organisation for Security and Cooperation in Europe, Podujeva Municipal Profile (2011).

njëra është humanitare, e dyta e të rinjëve, dhe e treta e grave.<sup>33</sup> Besimtarët protestantë në shërbim të tyre e kanë një kishë dhe dy klerikë protestantë.<sup>34</sup>

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u janë bashkangjitur tre individë nga komuna e Podujevës, përkatësisht, 0.03 individë në 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë që ata kanë nivel të ulët dhe të mesëm të shkollimit, dhe se janë të një gjendjeje ekonomike të dobët. Sa i përket gjinisë së këtyre individëve, dy janë femra dhe një është mashkull, dhe moshja e tyre ndryshon nga 20 deri në 30 vjet. Po ashtu, duhet theksuar se në komunën e Podujevës janë dy individë të arrestuar për veprimtari terroriste apo për vepra të tjera të ndërlidhura me këtë veprimtari.<sup>35</sup>

Këtu duhet theksuar se nuk ka evidencë publike që dëshmon se Kuvendi Komunal i Podujevës deri më tash ka mbajtur qoftë edhe një mbledhje e vetme ku do të trajtohej ky problem i sigurisë.<sup>36</sup>

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Podujevës tregojnë që brenda vitit të kaluar (2019) në këtë Komunë janë kryer 950 vepra penale,<sup>37</sup> domethënë 11 vepra penale për 1000 banorë, një shifër kjo që e pasqyron një nivel të mesëm të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (454) dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (235).<sup>38</sup>

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Podujevës tregojnë se nga 61,691 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 35.9% janë ekonomikisht aktivë – ndërsa vetëm 50.4% prej tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 49.6% e popullsisë mbi 15

---

<sup>33</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>34</sup> Të dhëna nga Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018.


<sup>35</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>36</sup> Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Podujevës. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/category/procesverbalet/?page=NaN>

<sup>37</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>38</sup> Ibid.

vjet.<sup>39</sup> Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 50.4% kanë deklaruar që kujdesen për familjen apo shtëpinë, ndërsa 29.6% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit. Këtu duhet të ceket se 3.9% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.8% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.<sup>40</sup>



- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2020, komuna e Podujevës ka buxhet prej rreth 24 milionë €. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, të cilat e përbëjnë rreth 94.1% të totalit të tij ndërsa rreth 5.9% Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Rreth 50.8% të buxhetit shpenzohen për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 9.63%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 28% e buxhetit komunal.

<sup>39</sup> Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.


<sup>40</sup> Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.





Nëse analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe subvencionet për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, dhe më në veçanti, me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk i përfaqëson në asnjë mënyrë nevojat e këtij grupi të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 27.5% të popullatës së përgjithshme të Komunës së Podujevës.

Në buxhetin e vitit 2020, vetëm 0.86% (207,138 €) të buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që do të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe të subvencioneve, duke paraqitur 2.8% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 48.3% e kësaj shume është dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 51.7% për shpenzime kapitale<sup>41</sup>.





<sup>41</sup> Ibid.

## Profili i Komunës së Glllogocit

### Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullsisë dhe lëvizjet demografike**

Glllogoci është komuna e tretë në Rajonin e Prishtinës për nga numri i popullsisë. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë se Komuna e Glllogocit i ka patur 58,531 banorë, ndërkaq, deri në vitin 2018 kjo shifër është rritur për 2439 banorë, që don të thotë se Glllogoci tash i ka 60,970 banorë.<sup>42</sup> Sipas përkatësisë etnike, 99.8% e banorëve të Glllogocit janë shqiptarë, ndërsa 0.2% e tyre u përkasin grupeve etnike të tjera. Raporti gjinor i popullatës është 50.8% meshkuj dhe 49.2% femra.



Kjo analizë është përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta paraqesin 29.7% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (29.5%), dhe 30-80 vjet (40.8%).<sup>43</sup> Regjistrimi i popullsisë tregon se numri më i madh i të rinjëve në Komunën e Glllogocit (89.7%) jetojnë në fshatra, ndërkaq, pjesa tjetër prej 10.3% jeton në qytet.<sup>44</sup>

<sup>42</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku:

<http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullsisë-2017.pdf>

<sup>43</sup> Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>44</sup> Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat lidhur me nivelin e arsimit dhe njohjen e lexim-shkrimit për popullatën mbi 10 vjet tregojnë se në 1000 banorë, 38 janë analfabetë, 90 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 517 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 332 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 60 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare.<sup>45</sup>

Komuna e Glogocit i ka gjithsej 32 shkolla fillore dhe të mesme, me 745 mësimdhënës,<sup>46</sup> dhe me një raport prej 1.38 shkollash në 1000 banorë të moshës deri në 19-vjeç.

Në Komunën e Glogocit funksionojnë 30 klube sportive që i kanë në dispozicion dy stadione, tri fusha sportive dhe një palestër sportive. Po ashtu, në komunë funksionojnë katër biblioteka, një shtëpi e kulturës dhe katër shoqëri kulturore.<sup>47</sup>

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 99% e popullatës së Glogocit janë deklaruar të besimit Islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, 1% e banorëve, 0.3% janë të besimit katolik dhe 0.7% kanë preferuar të mos përgjigjen.<sup>48</sup>

Në territorin e Komunës së Glogocit janë funksionale 18 xhami, një prej të cilave është në qytet dhe 17 ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve Islamë është 16.<sup>49</sup> Këtu duhet theksuar që në periudhën kohore 2011-2018, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve Islamë kanë hyrë tri xhami të reja.<sup>50</sup> Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.3 xhami në 1000 banorë, ndërkaq, në qytet 0.16 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, e dyta e të rinjëve, dhe e treta e grave.<sup>51</sup> Besimtarët katolikë kanë në

---

<sup>45</sup> Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>46</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

<sup>47</sup> Infrastruktura Kulturore dhe Sportive në Komunën e Glogocit. Të dhëna të dërguara nga Drejtoria e Kulturës në Komunën e Glogocit, Qershor 2020.

<sup>48</sup> Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>49</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>50</sup> Organisation for Security and Cooperation in Europe, Drenas Municipal Profile (2011).

<sup>51</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

shërbim të tyre një kishë katolike, ndërkaq, besimtarët protestantë në shërbim të tyre e kanë një kishë dhe dy klerikë protestantë.<sup>52</sup>

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u është bashkangjitur një individ nga komuna e Glllogocit, përkatësisht, 0.01 individë në 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtij individ tregojnë se ai ka nivel të mesëm të shkollimit, dhe se është i një gjendjeje ekonomike të dobët. Ky individ bën pjesë në grup-moshën 20-25 vjeçare. Po ashtu, duhet theksuar se në komunën e Glllogocit janë dy individë të arrestuar për veprimtari terroriste apo për vepra të tjera të ndërlidhura me këtë veprimtari.<sup>53</sup>

Këtu duhet theksuar edhe atë se nuk ka evidencë publike që dëshmon se Kuvendi Komunal i Glllogocit deri më tash ka mbajtur qoftë edhe një mbledhje të vetme ku do të trajtohej ky problem i sigurisë.<sup>54</sup>

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Glllogocit tregojnë se brenda vitit të kaluar (2019) në këtë komunë janë kryer 717 vepra penale,<sup>55</sup> që don të thotë, 12 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel mesatar të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (361), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (171).<sup>56</sup>

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Glllogocit tregojnë se nga 61,691 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 40.3% janë ekonomikisht aktivë – ndërsa vetëm 44% prej tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 59.7% e popullsisë mbi 15 vjet.<sup>57</sup>

---

<sup>52</sup> Të dhëna nga Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018.

<sup>53</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.


<sup>54</sup> Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Drenasit. <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/category/dokumentet-e-kuvendit/procesverbalet-e-kuvendit/>

<sup>55</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>56</sup> Ibid.

<sup>57</sup> Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.





Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 49.5% kanë deklaruar se kujdesen për familjen apo shtëpinë, ndërsa 32.9% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit. Këtu duhet theksuar se 7.1% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq 6.8% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.<sup>58</sup>

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore**

Për vitin 2020, Komuna e Glogocit ka buxhet prej rreth 16.5 milionë €. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, që paraqesin rreth 91.5% të totalit të tij, ndërsa rreth 8.5% të buxhetit Komuna e gjeneron nga të hyrat vetanake. Rreth 51.2% të buxhetit total shpenzohen për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 10.8%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 28.4% e shumës totale.<sup>59</sup>


<sup>58</sup> Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>59</sup> Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>.



Nëse analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe subvencionet për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, dhe më në veçanti, me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk i përfaqëson në asnjë mënyrë nevojat e këtij grupi të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 29.7% të popullatës së përgjithshme të Komunës së Glllogocit.

Në buxhetin e vitit 2020, vetëm 1.8 % (301,100 €) të buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që do të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe të subvencioneve, duke e paraqitur 6.07% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 26.5% e kësaj shume, është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 73.5% për shpenzime kapitale.<sup>60</sup>





<sup>60</sup> Ibid.

## Profili i Komunës së Lipjanit

### Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullsisë dhe lëvizjet demografike**

Për nga numri i banorëve, Lipjani është komuna e katërt në Rajonin e Prishtinës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë se Komuna e Lipjanit i ka patur 57,605 banorë, dhe se deri në vitin 2018 kjo shifër është rritur për 102 banorë, që don të thotë se Lipjani tash i ka 57,707 banorë.<sup>61</sup> Sipas përkatësisë etnike, 94.5% e banorëve të Lipjanit janë shqiptarë, 3.14% janë ashkali, 0.9% janë serbë dhe pjesa tjetër i përket grupeve etnike të tjera. Raporti gjinor i popullatës është 50.9% meshkuj, dhe 49.1% femra.



Kjo analizë është përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta paraqesin 27.5% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (29.8%) dhe 30-80 vjet (42.7%).<sup>62</sup> Regjistrimi i popullsisë tregon se numri më i madh i të rinjëve të Komunës së Lipjanit (88.1%) jetojnë në fshatra, ndërkaq, pjesa tjetër prej 11.9% jeton në qytet.<sup>63</sup>

<sup>61</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku:

<http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullsisë-2017.pdf>

<sup>62</sup> Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>63</sup> Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat lidhur me nivelin e arsimit dhe njohjen e lexim-shkrimit për popullatën mbi 10 vjet tregojnë se në 1000 banorë, 51 janë analfabetë, 92 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 528 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 303 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 56 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare.<sup>64</sup>

Komuna e Lipjanit ka gjithsej 54 shkolla fillore dhe të mesme me 801 mësimdhënës,<sup>65</sup> me një raport prej 2.35 shkollash në 1000 banorë të moshës deri në 19-vjeç.

Në Komunën e Lipjanit funksionojnë 15 klube sportive që i kanë në dispozicion tre stadione, shtatë salla sportive dhe 42 fusha sportive. Po ashtu, në komunë funksionojnë tre biblioteka, një shtëpi e kulturës dhe një kinema.<sup>66</sup>

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 97.8% e popullatës së Lipjanit janë deklaruar të besimit Islam, ndërkaq, 0.9% janë të besimit katolik dhe 0.9% janë të besimit katolik.

Në territorin e Komunës së Lipjanit janë funksionale 32 xhami, një prej të cilave është në qytet dhe 31 ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve Islamë është 34.<sup>67</sup> Këtu duhet theksuar që në periudhën kohore 2011-2018, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve Islamë kanë hyrë tri xhami të reja <sup>68</sup>. Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.61 xhami në 1000 banorë, ndërkaq, në qytet 0.14 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, e dyta e të rinjëve, dhe e treta e grave.<sup>69</sup> Besimtarët katolikë kanë në shërbim të tyre një kishë katolike, besimtarët protestantë kanë katër klerikë por asnjë kishë, ndërsa besimtarët ortodoksë kanë në shërbim të tyre tri kisha ortodokse.

---

<sup>64</sup> Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>65</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

<sup>66</sup> Infrastruktura Kulturore dhe Sportive në Komunën e Lipjanit. Të dhëna të dërguara nga Drejtoria e Kulturës në Komunën e Lipjanit, qershor 2020.

<sup>67</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>68</sup> Organisation for Security and Cooperation in Europe, Lipjan Municipal Profile (2011),

<sup>69</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.



- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u janë bashkangjitur 11 individë nga komuna e Lipjanit, që don të thotë, 0.2 individë në 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë se ata kanë nivel të mesëm të shkollimit, dhe se janë të një gjendjeje ekonomike të dobët. Sa i përket gjinisë, shtatë prej tyre janë meshkuj, kurse katër janë femra, dhe mosha e tyre ndryshon nga 19 deri në 50 vjet. Po ashtu, duhet theksuar se në komunën e Lipjanit janë pesë individë të arrestuar për veprimtari terroriste apo për vepra tjera të ndërlidhura me këtë veprimtari.<sup>70</sup> Këtu duhet theksuar se nuk ka evidencë publike që dëshmon se Kuvendi Komunal i Lipjanit deri më tash e ka mbajtur qoftë edhe një mbledhje të vetme ku do të trajtohej ky problem i sigurisë.<sup>71</sup>

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Lipjanit tregojnë se brenda vitit të kaluar (2019) në këtë komunë janë kryer 877 vepra penale,<sup>72</sup> që don të thotë 15 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel të mesëm të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (436), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (202).<sup>73</sup>

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Lipjanit tregojnë se nga 40,410 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 39.8% janë ekonomikisht aktivë – ndërsa vetëm 50.6% prej tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 60.1% e popullsisë mbi 15 vjet.<sup>74</sup> Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

---


<sup>70</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>71</sup> Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Lipjanit <https://kk.rks.gov.net/lipjan/category/procesverbalet/ekstraktet-e-procesverbaleve-te-kuvendit/>

<sup>72</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>73</sup> Ibid.

<sup>74</sup> Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.





Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 50.8% kanë deklaruar se kujdesen për familjen apo shtëpinë, ndërkaj, 29.3% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit. Këtu duhet të ceket se 7.9% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaj, 6.7% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.<sup>75</sup>

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2020, komuna e Lipjanit ka buxhet prej rreth 18 milionë €. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, që përbëjnë rreth 88.4% të totalit të tij, ndërsa rreth 11.5% Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Rreth 51.6% të buxhetit total shpenzohen për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 8.4%, ndërkaj, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 28.2% e shumës totale.<sup>76</sup>


<sup>75</sup> Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>76</sup> Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>



Nëse analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe subvencionet për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, dhe më në veçanti, me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk i përfaqëson në mënyrë të kënaqshme nevojat e këtij grupi të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që paraqet 27.5% të popullatës së përgjithshme të Komunës së Lipjanit.

Në buxhetin e vitit 2020, vetëm 3.5% (637,000 €) të buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që do të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe të subvencioneve, duke paraqitur 11.7% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 11.8% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 88.2% për shpenzime kapitale.<sup>77</sup>





<sup>77</sup> Ibid

## Profili i Komunës së Fushë Kosovës

### Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullsisë dhe lëvizjet demografike**

Për nga numri i banorëve, Fushë Kosova është komuna e pestë në Rajonin e Prishtinës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë se Komuna e Fushë Kosovës i ka patur 34,827 banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër është rritur për 4,117 banorë, që don të thotë se komuna e Fushë Kosovës tash i ka 38,944 banorë.<sup>78</sup> Sipas përkatësisë etnike, 86.9% të banorëve të Fushë Kosovës janë shqiptarë, 9.3% janë ashkali, 1.25% janë romë, 0.92% janë serbë, dhe pjesa tjetër i përket grupeve etnike të tjera. Raporti gjinor i popullatës është 50.6% meshkuj dhe 49.4% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta paraqesin 26.6% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (28.7%) dhe 30-80 vjet (44.7%).<sup>79</sup> Regjistrimi i popullsisë tregon se numri më i madh i të rinjëve në komunën e Fushë Kosovës, 51.5%, jeton në qytet, ndërsa pjesa tjetër prej 48.5% jeton në fshatra.<sup>80</sup>

<sup>78</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku:

<http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullsise-2017.pdf>

<sup>79</sup> Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>80</sup> Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat lidhur me nivelin e arsimit dhe njohjen e lexim-shkrimit për popullatën mbi 10 vjet tregojnë se në 1000 banorë, 59 janë analfabetë, 114 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 425 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 369 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 92 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare.<sup>81</sup>

Komuna e Fushë Kosovës i ka gjithsej 16 shkolla fillore dhe të mesme me 367 mësimdhënës,<sup>82</sup> dhe me një raport prej 1.21 shkollash në 1000 banorë të moshës deri në 19 vjeç. Komuna e Fushë Kosovës ka një shtëpi të kulturës dhe një bibliotekë dhe gjashtë shoqëri kulturore. Aktivitetet sportive të gjithsej 26 klubeve sportive të regjistruara zhvillohen në 13 sallat sportive dhe 15 fushat sportive të komunës.<sup>83</sup>

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 97.7% e popullatës së Fushë Kosovës janë deklaruar të besimit Islam, ndërkaq, 1.2% janë të besimit ortodoks, 0.2% janë të besimit katolik, ndërsa pjesa tjetër kanë preferuar të mos përgjigjen.

Në territorin e komunës së Fushë Kosovës janë funksionale 15 xhami, dy prej të cilave janë në qytet dhe 13 ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve Islamë është 18.<sup>84</sup> Këtu duhet theksuar se në periudhën kohore 2011-2018, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve Islamë kanë hyrë tetë xhami të reja.<sup>85</sup> Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.8 xhami në 1000 banorë, ndërkaq, në qytet ky raport është 0.1 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, e dyta e të rinjëve, dhe e treta e grave.<sup>86</sup> Besimtarët ortodoksë në shërbim të tyre i kanë dy kisha ortodokse, ndërsa besimtarët protestantë kanë pesë klerikë protestantë, por asnjë kishë.

---

<sup>81</sup> Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>82</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

<sup>83</sup> Të dhëna të dërguara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Fushë Kosovë, 18 qershor 2020.

<sup>84</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>85</sup> Organisation for Security and Cooperation in Europe, Fushë Kosova Municipal Profile (2011).

<sup>86</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u janë bashkangjitur gjashtë individë nga komuna e Fushë Kosovës, që don të thotë, 0.17 individë në 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë se ata kanë nivel të mesëm të shkollimit, dhe se janë të një gjendjeje ekonomike të dobët. Sa i përket gjinisë së këtyre individëve, ata që të gjithë janë meshkuj, dhe mosha e tyre ndryshon nga 19 deri në 50 vjet. Po ashtu, duhet theksuar se në komunën e Fushë Kosovës janë dy individë të arrestuar për veprimtari terroriste apo për vepra tjera të ndërlidhura me këtë veprimtari.<sup>87</sup> Këtu duhet theksuar edhe ajo se nuk ka evidencë publike që dëshmon që Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës deri më tash e ka mbajtur qoftë edhe një mbledhje të vetme ku do të trajtohej ky problem i sigurisë.<sup>88</sup>

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Fushë Kosovës tregojnë se brenda vitit të kaluar (2019) në këtë Komunë janë kryer 1262 vepra penale,<sup>89</sup> domethënë, 36 vepra penale për 1000 banorë, një shifër kjo që e pasqyron një nivel të lartë të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale të kryera hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (608), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (319).<sup>90</sup>

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Fushë Kosovës tregojnë se nga 24,831 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 47.8% janë ekonomikisht aktivë – ndërsa 63.9% prej tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 52.2% e popullsisë mbi 15 vjet.<sup>91</sup> Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

---


<sup>87</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>88</sup> Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/category/procesverbalet-per-kuvend-dhe-komitete/ekstraktet-e-procesverbaleve-te-kuvendit/?page=2016>

<sup>89</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>90</sup> Ibid.

<sup>91</sup> Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.





Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 46% e tyre kanë deklaruar që kujdesen për familjen apo shtëpinë, ndërsa 31.8% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit. Këtu duhet të ceket se 8.2% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.5% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.<sup>92</sup>

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore**

Për vitin 2020, Komuna e Fushë Kosovës ka buxhet prej rreth 12.6 milionë €. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, që përbëjnë rreth 77.7% të totalit të tij, ndërsa rreth 22.3% Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Rreth 38.5% të buxhetit total shpenzohen për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 12.7%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 38.6% e shumës totale.<sup>93</sup>


<sup>92</sup> Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>93</sup> Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>



Nëse analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe subvencionet për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, dhe më në veçanti, me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk i përfaqëson në asnjë mënyrë nevojat e këtij grupi të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), i cili paraqet 26.6% të popullatës së përgjithshme të komunës së Fushë Kosovës.

Në buxhetin e vitit 2020, vetëm 2.1% (265,000 €) të buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që do të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe të subvencioneve, duke paraqitur 5.12% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 13.3% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 86.7% për shpenzime kapitale.<sup>94</sup>



<sup>94</sup> Ibid.





## Profili i Komunës së Obiliqit

### Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullsisë dhe lëvizjet demografike**

Për nga numri i banorëve, komuna e Obiliqit është e gjashta në Rajonin e Prishtinës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë se komuna e Obiliqit i ka patur 21,549 banorë dhe se deri në vitin 2018 kjo shifër ka rënë për 2,889 banorë, që don të thotë se komuna e Obiliqit tash i ka 18,660 banorë.<sup>95</sup> Sipas përkatësisë etnike, 92.1% e banorëve të Obiliqit janë shqiptarë, 3% janë romë, 2.7% janë ashkali, 1.3% janë serbë dhe pjesa tjetër i përket grupeve etnike të tjera. Raporti gjinor i popullatës është 50.5% meshkuj dhe 49.5% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 27.1% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (29.8%) dhe 30-80 vjet (43.1%).<sup>96</sup> Regjistrimi i popullsisë tregon se numri më i madh i të rinjëve në Komunën e Obiliqit (68.5%) jetojnë në fshatra, ndërkaq, pjesa tjetër prej 31.5% jeton në qytet.<sup>97</sup>

<sup>95</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku:

<http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullsisë-2017.pdf>

<sup>96</sup> Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>97</sup> Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat lidhur me nivelin e arsimit dhe njohjen e lexim-shkrimit për popullatën mbi 10 vjet tregojnë se në 1000 banorë, 43 janë analfabetë, 103 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 454 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 387 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 54 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare.<sup>98</sup>

Komuna e Obiliqit ka gjithsej 18 shkolla fillore dhe të mesme me 321 mësimdhënës,<sup>99</sup> dhe me një raport prej 2.14 shkollash në 1000 banorë të moshës deri në 19 vjeç.

Komuna e Obiliqit ka tre shtëpi të kulturës dhe katër shoqëri kulturore. Aktivitetet sportive të gjithsej 14 klubeve sportive të regjistruara zhvillohen në pesë fusha sportive, 14 poligone e hapura sportive dhe në dy salla sportive.<sup>100</sup>

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 97.7% e popullatës së Obiliqit janë deklaruar të besimit Islam, ndërkaq, 1.2% janë të besimit ortodoks, dhe 0.7% e banorëve kanë preferuar të mos përgjigjen.

Në territorin e Komunës së Obiliqit janë funksionale 18 xhami, dy prej të cilave janë në qytet dhe 16 ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve Islamë është 20.<sup>101</sup> Këtu duhet theksuar që në periudhën kohore 2011-2018 në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve Islamë kanë hyrë tri xhami të reja.<sup>102</sup> Raporti xhami për banorë në fshatra është 1.1 xhami në 1000 banorë, ndërkaq në qytet ky raport është 0.3 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, e dyta e të rinjëve, dhe e treta e grave.<sup>103</sup> Besimtarët ortodoksë në shërbim të tyre kanë tri kisha ortodokse ndërsa besimtarët protestantë kanë një klerik fetar por asnjë kishë.

---

<sup>98</sup> Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>99</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

<sup>100</sup> Të dhëna të dërguara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Obiliq, Qershor 2020.

<sup>101</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>102</sup> Organisation for Security and Cooperation in Europe, Obiliq Municipal Profile (2011).

<sup>103</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak u janë bashkangjitur pesë individë nga komuna e Obiliqit, që don të thotë, 0.23 individë në 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë se ata kanë nivel të mesëm të shkollimit dhe se janë të një gjendjeje ekonomike të dobët. Sa i përket gjinisë, tre nga këta individë janë meshkuj dhe dy janë femra, dhe mosha e tyre ndryshon nga 20 deri në 30 vjet. Po ashtu, duhet theksuar se në komunën e Obiliqit janë tre individë të arrestuar për veprimtari terroriste apo për vepra të tjera të ndërlidhura me këtë veprimtari.<sup>104</sup> Këtu duhet theksuar edhe se nuk ka evidencë publike që dëshmon që Kuvendi Komunal i Obiliqit deri më tash ka mbajtur qoftë edhe një mbledhje e vetme ku do të trajtohej ky problem i sigurisë.<sup>105</sup>

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në komunën e Obiliqit tregojnë se brenda vitit të kaluar (2019) në këtë komunë janë kryer 327 vepra penale,<sup>106</sup> që don të thotë, 15 vepra penale për 1000 banorë, një shifër kjo që e pasqyron një nivel mesatar të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale bëjnë pjesë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (166) dhe të atyre kundër jetës dhe trupit (96).<sup>107</sup>

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për komunën e Obiliqit tregojnë se nga 15,130 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 46.3% janë ekonomikisht aktivë – ndërsa vetëm 53.3% prej tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 53.1% e popullsisë mbi 15 vjet.<sup>108</sup> Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

---


<sup>104</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>105</sup> Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Obiliqit LINK

<sup>106</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

<sup>107</sup> Ibid.

<sup>108</sup> Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.





Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 49.5% kanë deklaruar se kujdesen për familjen apo shtëpinë, ndërsa, 32.1% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit. Këtu duhet të theksohet se 8.9% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërsa, 9.3% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.<sup>109</sup>

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2020, komuna e Obiliqit ka buxhet prej rreth 11.4 milionë €. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, që përbëjnë rreth 91% të totalit të tij, ndërsa, rreth 9% Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Rreth 35.6% të buxhetit total shpenzohen për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 7.2%, ndërsa, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 42.9% e shumës totale.<sup>110</sup>


<sup>109</sup> Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>110</sup> Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>



Nëse analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe subvencionet për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, dhe më në veçanti, me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk i përfaqëson në mënyrë të kënaqshme nevojat e këtij grupi të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet) që e paraqet 27.1% të popullatës së përgjithshme të komunës Obiliqit.

Në buxhetin e vitit 2020, vetëm 5.3% (605,000 €) të buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që do të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe të subvencioneve, duke paraqitur 10.65% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 15.7% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 84.3% për shpenzime kapitale<sup>111</sup>.




<sup>111</sup> Ibid.

## **Profili i Komunës së Graçanicës**

### **Fakte dhe shifra**

- **Struktura e popullsisë dhe lëvizjet demografike**

Komuna e Graçanicës është komuna e vetme rurale në Rajonin e Prishtinës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë se Komuna e Graçanicës i ka patur 10,675 banorë, ndërkohë që deri në vitin 2018 kjo shifër ka rënë për 1,391 banorë, që don të thotë se komuna e Graçanicës tash i ka 12,066 banorë.<sup>112</sup> Sipas përkatësisë etnike, 67.5% të banorëve të Graçanicës janë serbë, 23.2% janë shqiptarë, 7% janë romë, 1% janë ashkali dhe pjesa tjetër i përket grupeve etnike të tjera. Raporti gjinor i popullatës është 50.7% meshkuj dhe 49.3% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 25.2% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (25%) së bashku me 30-80 vjet (49.8%).<sup>113</sup>

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat lidhur me nivelin e arsimit dhe njohjen e lexim-shkrimit për popullatën mbi 10 vjet tregojnë se në 1000 banorë, 26 janë analfabetë, 76 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të

<sup>112</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Linku: <http://ask.rks.gov.net/media/4118/vlersimi-i-popullise-2017.pdf>

<sup>113</sup> Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

shkollimit, 377 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 452 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 84 i kanë përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare.<sup>114</sup>

Komuna e Graçanicës ka gjithsej 17 shkolla fillore dhe të mesme, me 550 mësimdhënës,<sup>115</sup> ku në një shkollë fillore mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërsa në të tjerat në gjuhën serbe dhe në bazë të kurrikulës së Serbisë, dhe me një raport prej 4.8 shkollash në 1000 banorë të moshës deri në 19 vjet.

Sa i përket infrastrukturës së sportit dhe të kulturës, Komuna e Graçanicës ka një fushë të futbollit<sup>116</sup> dhe një shtëpi të kulturës.<sup>117</sup>

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 67.8% e popullatës së Graçanicës janë deklaruar të besimit Ortodoks, ndërkaq, 29.9% janë të besimit Islam, ndërsa 1.33% e banorëve kanë preferuar të mos përgjigjen.

Në territorin e Komunës së Graçanicës është funksionale një xhami, dhe numri i klerikëve Islamë është një.<sup>118</sup> Raporti xhami për banorë është 0.1 xhami në 1000 banorë. Besimtarët ortodoksë kanë në shërbim të tyre 11 kisha dhe një manastir ortodoks.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Në komunën e Graçanicës nuk është shënuar asnjë rast i bashkangjites së qytetarëve të kësaj komune grupeve terroriste në Lindjen e Mesme.

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Graçanicës tregojnë se brenda vitit të kaluar (2019) në këtë Komunë janë kryer 512 vepra penale,<sup>119</sup> që don të thotë 48 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel shumë të lartë të kriminalitetit.

---

<sup>114</sup> Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>115</sup> Organisation for Security and Cooperation in Europe, Gračanica Municipal Profile (2018)

<sup>116</sup> Stadium Gračanica, 2020, <http://wikimapia.org/26071323/Stadium>

<sup>117</sup> Dom Kulture Gračanica, <https://www.facebook.com/pg/domkulturegracanica/reviews/>


<sup>118</sup> Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

<sup>119</sup> Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 19 maj 2020.

Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (248), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (106).<sup>120</sup>

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Graçanicës tregojnë se nga 8,012 persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 50.3% janë ekonomikisht aktivë – ndërsa vetëm 63.1% prej tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 49.7% e popullsisë mbi 15 vjet.<sup>121</sup> Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktivë, 31.9% kanë deklaruar që kujdesen për familjen apo shtëpinë ndërsa 31.4% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit. Këtu duhet të ceket se 4% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 9.9% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.<sup>122</sup>

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin 2020, komuna e Graçanicës ka buxhet prej rreth 8.1 milionë €. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga grantet qeveritare, të cilat përbëjnë rreth 77.9% të totalit të tij ndërsa



<sup>120</sup> Ibid.

<sup>121</sup> Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

<sup>122</sup> Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.



rreth 22.1% Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Rreth 36.8% të buxhetit total shpenzohen për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 16.3%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është rreth 31.4% e shumës totale.<sup>123</sup>



Nëse analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe subvencionet për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe të sportit, dhe më në veçanti, me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk i përfaqëson në asnjë mënyrë nevojat e këtij grupi të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet) që paraqet 25.2% të popullatës së përgjithshme të Komunës Graçanicës.

Në buxhetin e vitit 2020, vetëm 0.74% (60,000 €) të buxhetit total parashihet të shpenzohet në një mënyrë që do të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në kuadrin e shpenzimeve kapitale dhe të subvencioneve, duke e paraqitur 2.2% të këtyre shpenzimeve. Për më tepër, 100% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere.<sup>124</sup>

<sup>123</sup> Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

<sup>124</sup> Ibid.



Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: " Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim"

